




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.9, datë 24.03.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “GRABOVA HYDROPOWER” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin elejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Grabova Hydropower”, me adresë Rruga “Sami Frashëri” Nr. Banimit 19 kati i 8 Bashkia Tiranë sipas kontratës së koncesionit të formës “Bot” për ndërtimin e hidrocentralit “Grabova 1” me nr.2623, Rep; 1238/3 Kol të lidhur më date 20.11.2017 midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe subjektit “Grabova Hydropower” sh.p.k.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Grabova 1

- Prodhimi vjetor i parashikuar: 63.740.620 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 14.900 kw

- Vlera totale e investimit: 2.525.488.629,0 lekë pa TVSH
- Kohëzgjatja e zbatimit të punimeve: 24 muaj
- Kohëzgjatja e kontratës 35 vjet

Vendndodhja e burimit ujqor Lumi Grabova

- X=532343,896; Y=4515890,296; Z=867,2 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 3400l/s
- Prurja mesatare vjetore: 2,988,000l/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 1,379 l/s
- Prurja ekologjike: 386 l/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 Lumi Grabova

- X=532343,896; Y=4515890,296; Z=867,2 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore: 2,230l/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 1,030l/s
- Prurja llogaritëse: 2,552 l/s
- Prurja ekologjike: 288 l/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2Përroi i Babunit

- X=532385,313; Y=4515017,938; Z=871,5 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore: 758 l/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 1,100l/s
- Prurja llogaritëse: 866 l/s
- Prurja ekologjike: 98 l/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X=526926,457; Y=4514139; Z=356,5 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
- Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBUSEMAN

LEFTER SHEHAJ

